



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 27 Prill 2021

Nr: 214

**U R D H Ë R**

**P Ë R**

**ECURINË E PROCESIT TË NUMËRIMIT TË FLETËVE TË VOTIMIT PËR  
KANDIDATËT E LISTAVE SHUMEMËRORE TË SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR  
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “b” e “n”, e 2, dhe 118 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 12, të vendimit nr. 14 datë 10.04.2021, të Komisionit Rregullator, “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, rradhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votive dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend”, të ndryshuar

**URDHËROJ:**

1. KZAZ-të të cilat kanë përfunduar numërimin e votave për subjektet zgjedhore dhe kanë miratuar me vendim tabelën përmbledhëse të rezultateve për ZAZ-në, të fillojnë numërimin dhe vlerësimin e votave për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore, në datën 28.04.2021 në orën 9:00.
2. KZAZ-të të cilat janë akoma në proces numërimi të votave për subjektet zgjedhore, duhet ta përfundojnë procesin e numërimit dhe miratimit të tabelës përmbledhëse të rezultateve brenda orës 24.00, të datës 27.04.2021, dhe të fillojnë procesin e numërimit të fletëve të votimit për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore në orën 9.00 të datës 28.04.2021.
3. Në ato KZAZ ku ka filluar numërimi i votave për kandidatët, procesi i numërimit do të vijojë deri në orën 24:00 të datës 27.04.2021, dhe do të rifillojë nesër në datë 28.04.2021, në orën 9:00. Në rast se të gjithë anëtarët e një KZAZ, për shkak të pamundësisë fizike,



Data: 27 Prill 2021

Nr. 214

“Për ecurinë e procesit të numërimit të fletëve të votimit për kandidatët e listave shumemërore të subjekteve zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”

nuk mundet të vazhdojnë numërimin deri në ora 24:00 të datës 27.04.2021, me vendim ata e ndërpresin procesin për ta rifilluar ditën e nesërme, datë 28.04.2021.

4. Subjektet zgjedhore te marrin masat organizative për të patur gati grupet e numërimit në çdo KZAZ në orën 9.00 të datës 28.04.2021.
5. Nga ora 9.00 e datës 28.04.2021 e në vazhdim, procesi i numërimit të votave për kandidatët do të vazhdojë pandërprerje. Braktisja e detyrës nga anëtari/sekretari i KZAZ-së apo anëtari i GNV-së, passjell sanksione penale dhe administrative dhe në cdo rast Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve do të marrë masat organizative për zëvendësimin e tyre dhe vazhdimin normal të procesit.
6. Ngarkohen KZAZ-të dhe GNV-të për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**